



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-24-12155-1-3-6/C822



K O N T R A T Ë /FURNIZIM

Emri i Projektit: **Furnizimi dhe blerja e rrobave te punes per Puntoret e Njesise Profesionale te Zjarrfikesve dhe Shpetimit - Drenas**

Numri identifikues: : **611-24-12155-136**, Datë: **19.12.2024**; Nr. i arkivit; **400-01/60118**

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - Zveçan, përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës").

" Sankos " Sh.p.k., rr. "Vëllezerit Çaka"pn, Kaçanik, përfaqësuar nga **XHAVIT NEZIRAJ** , Drejtor (më tutje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Furnizimi dhe blerja e rrobave te punes per Puntoret e Njesise Profesionale te Zjarrfikesve dhe Shpetimit - Drenas**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të **furnizimeve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹. Periudha e kryjes së punëve/shërbimeve dhe **furnizimeve** do të jetë deri në afatin : **7 dite**.

Neni 3 Çmimi

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **3,638.00 €**; **Tremijë e Gjashtëqindë e Tredhjetë e Tetë euro EURO]**

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit te projektit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së **furnizimeve** duhet të jetë brenda 10 dite. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DSHPE-se.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **furnizimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **furnizimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve**/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit., dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunes.

Neni 7 Garancioni i shërbimeve

7.1 Garancioni nuk kërkohe.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit

kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.





13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**




Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **menjhere pas nenshkrimit.**

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GENTIANA QELA	Emri:	XHAVIT NEZIRAJ
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënskrimi:		Nënskrimi:	
Data:	19.12.2024	Data:	19.12.2024
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA SE BASHKU ME SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR UNIFORMA TË PUNËS PËR ZJARRFIKËSVE					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA SE BASHKU ME SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR UNIFORMA TË PUNËS PËR ZJARRFIKËSVE		Njësia	sasia	Çmimi	Çmimi total
1	Xhaketë Fosforeshente Flakduruese				
	<p>Xhaketë Fosforeshente Flakduruese Xhaketa të jetë e rezistueshme në temperaturat dhe flakë duruese, mbrojtje nga shumë lloje të rreziqeve në mjedis të temperaturave të larta, ndërtim dhe material të qendroshëm edhe pas shumë larjeve. Në pjesën e pasme në shpinë të ketë mbishkrimin; ZJARRFIKËSIT E KOSOVËS</p> <p>Përmbajtja :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pelhur modakrilike • Ngjyra e verdhë dhe kaltër, më shirita reflektues, përdoruesit i mundëson dukshmeri të lartë dhe mbrojtje të plotë ndaj situatave të rrezikshme • Hapje me kapsa dhe zingjirë të fshehur <p>Standardi: AS/NZS 1906:4:2010 EN 1149-5 EN 13034 Tipi PB(6) EN ISO 11612(A1+A2, B2,C1 F1) EN ISO 11611 Klasa 1 A1+A2 EN ISO 20471 Klasa 2</p> 	copë	17	80.00	1,360.00
2	Pantallona Fasforoshene Flakdurues				
	 <p>Pantallona Fasforoshene Flakdurues Pantallonat të jenë e rezistueshëm në temperaturat dhe flakë duruese, siguron mbrojtje të shumë llojeve të rreziqeve, ndërtim dhe material të qendroshëm edhe pas shumë larjeve .</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pelhurë modakrilike • Ngjyrë e kaltër dhe verdhë më shirita reflektues, përdoruesit i mundëson dukshmeri të lartë dhe mbrojtje të plotë ndaj situatave të rrezikshme <p>Standardi: AS/NZS 1906:4:2010 EN 1149-5 EN 13034 Tipi PB(6) EN ISO 11612(A1+A2, B2,C1 F1) EN ISO 11611 Klasa 1 A1+A2 EN ISO 20471 Klasa 1</p>	copë	17	85.00	1,445.00
3	Këpucët				
	<p>Këpçë të ndërtuara për kushte të veshitura pune në teren , lekur e plotë Gomë që ofron mbrojtje maksimale, e fortë dhe e rehatshme. rezistente deri në 250 0C .si dhe rezistente ndaj rrëshqitjeve Këpçët duhet të jenë sipas standardeve : EN ISO 20345:20</p> 	copë	17	35.00	595.00
4	Maica Pollo				
	Maica me mëngë të shkurtra me jaka si dhe me nga tri pulla Ngjyrë e kalter e mbylltë .	copë	34	7	238
5	Rrypë				
	Rrypë beli, prej materialit të lëkures me gjatësi minale 1.5 m	copë	17	7	119

Rikapitullim pergjithshem per rroba rroba për zjarrfikës		
1	Xhakete Fosforeshente Flakdurese	
2	Pantallona Fasforoshene Flakdurees	1,360.00
3	Këpucët	1,445.00
4	Maica Pollo	595.00
5	Rrypë	238.00
	Total	119.00
		3,638.00

Rikapitullim për rroba të zyrtarve të Zjarrfikësve		
	Rikapitullim pergjithshem per rroba rroba për zjarrfikës	3,638.00
	Total	3,638.00

Shënim: Duhet të respektohen standartet e përshkruara në paramasë dhe një model/moster/ e rrobave të zjarrfikëse duhet të sillen moster para fillimit të liferimit të tyre

Plani dinamik 20 dit pune

Antigona Durmishi